



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E MITROVICËS-JUŽNA MITROVICA

Nr i Dokumentit: 01-052/01 - 0009530/25  
Data: 14.02.2025

Mitrovicë - Mitrovica



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Mitrovicë, 2025

## **Parathënje:**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës përbëhet nga tre sektorë: Sektori i Kulturës, i Rinisë dhe i Sportit, që në fakt përbëjnë edhe kompleksitetin e punës së kësaj drejtorie. Institucionet vartëse të saj janë: Qendra e Kulturës, Teatri i Qytetit, Ansambli i Qytetit, Biblioteka Komunale “Latif Berisha”, Muzeu i Qytetit, Palestra e Sporteve “Minatori”, Galeria e Arteve si dhe salla e sporteve “Fatime Xhaka” (Këto dy të fundit si dhe Ansambli aktualisht nuk janë funksionale). Personeli i Drejtorisë përbëhet nga gjithsejt 52 zyrtarë, si dhe 20 në teatër, të cilët punojnë në departamentet respektive, të ndarë sipas organogramëve përkatëse. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Mitrovicës në vazhdimësi ka paraparë ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve të saj në fusha të ndryshme. Në bashkëpunim me institucionet vartëse, ka planifikuar qëllimet dhe objektivat e saj për këtë vit, dhe, duke analizuar në hollësi buxhetin e planifikuar për këtë vit dhe duke pasur parasysh resurset njerëzore, ka planifikuar që gjatë këtij viti kalendarik të mbështesë në forma të ndryshme ngritjen e kapaciteteve në sektorët e saj, gjithmonë në bazë të ligjeve që rregullojnë punën institucionale dhe menaxhimit komunal. DKRS është përgjegjëse dhe aktive në punën e saj, në mënyrë që objektivat e parashikuara të arrihen dhe të respektohen aktivitetet tradicionale të sektorëve përkatës, të inicjojë bashkëpunime të reja dhe të nxisë investitorët të investojnë, si dhe të kërkojë fonde shtesë; Ky raport është hartuar në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë dhe përfshinë mbështetjen periudhën kohore Janar-Dhjetor 2024.

**Gjatë vitit 2024 buxheti i miratuar për Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport ka qenë në shumë prej 1,229.620 €, duke përfshirë dhe pagat.**

**Të ndara sipas kategorive kanë qenë:**

- Mallra dhe shërbime 85.000 €
- Shpenzime Komunale 80.000 €
- Subvencione dhe Transfere 300.000 € dhe
- Investime Kapitale 530.000 €.

Teatri i Qyetetit "Muharrem Qena" ka buxhetin e veqantë dhe për vitin 2024, totali i miratuar ka qenë 199,644 €.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përgjegjëse për detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Hartimin e planit për mbështetjen kulturore, sportive dhe rinore;
2. Udhëheqje me resurset lokale kulturore, rinore dhe sportive;
3. Udhëheqje me Teatrin, Bibliotekën e Qytetit, Muzeun e Qytetit, Qendrën e Kulturës, Palestrën e sporteve dhe hapësirat tjera përcjellëse;
4. Organizimin dhe shënimin e datave me rëndësi historike kur kërkohet;
5. Organizimin e debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës, rinisë dhe sportit;
6. Grumbullimin e shënimive faktike mbi të arriturat në kulturë, rini dhe sport;
7. Bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e Komunës dhe raportimin për punët e drejtorisë;
8. Bashkëpunim me nivelin qendror nga fushë veprimtaria përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;
9. Regjistrimin e grupeve, klubeve, ansambleve etj;
10. Mbështetje të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive;
11. Bashkëpunim me qytete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ, e organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;
12. Përkrahje dhe ndihmë asociacioneve, klubeve dhe shoqatave në aktivitetet e tyre;
13. Përkrahje, mbështetje dhe mbikqyrje të punës dhe funksionimit të Qendrës Rinore në përputhje me ligjin;
14. Të ofrojë institucionet e veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente edhe veprimtari të tjera);
15. Të nxisë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë;
16. Të organizojë anketa, seminare e trajnime të ndryshme, kyçje të të rinjve kosovarë në aktualitete rinore, evropiane e botërore;
17. Të ushtrojë edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

## Sektori i Kulturës

### 1. Aktivitetet kulturore tradicionale

- Festa e 17 shkurtit
- 1 Qershori dita e Fëmijëve
- Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës
- Kremtimi i festave tjera kombëtare dhe ndërkombejtare, si dhe shënim i përvjetorëve të rëndësishëm, sipas kalendarit të përpiluar nga Sektori i Kulturës
- Kremtimi i festes së 28 Nëntorit

### 2. Projektet kapitale afatgjata

- Objekti i përhershëm i Bibliotekës Komunale(Punët janë duke hecur sipas planit dinamik)
- Objekti i përhershëm i Muzeut të Qytetit( janë bërë investime të vogla ku edhe gjatë ketij viti parashihet të i ipet selia e përheshme dhe të fillojnë investimet kapitale)
- Renovimi i Qendrës së Kulturës është bërë edhe përrurimi i punimeve

### Punët administrative

- Janë përpunuar 120 lëndë
- Pjesë e komisionit Raporti i Performancës komunale për vitin 2023
- Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershori 2024
- Planin Lokal te Veprimit për Barazinë Gjinore të Komunës
- Komisionit për vlerësimin e pasurisë jo-financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut
- Strategjia për Kulturë 2024-2027 e cila gjatë muajit Qershori është aprovuar në kuvendin komunal

## AKTIVITETET E SEKTORIT TË KULTURËS

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e mbarëvejtjes së punëve në institucionet vartëse.
- Jemi duke punuar për formimin e komisionit për të hartuar planin ideor mbi renomvimet e Muzeut të qytetit.
- Koncert me rastin e 17 shkurtit “Sheshi Adem Jashari”
- Java e Frankofonisë në Mitrovicë
- Kremtimi i 6 Qershorit – Ditës së Dëshmorëve të Mitrovicës
- Koncert solistik recital me kitar nga Milot Mehmeti në hapësirë të sektorit të etnologjisë. Edicionit i 4-të i Festivalit të Letërsisë ZaNa mbrëmje letrare për të verbër, si dhe mbrëmje letrare ndërkombejtare.
- Shfaqje teatrale franceze "B+B= BB"
- Koncerti me rastin e 28 nëntorit
- Aktivitete kulturore të mbështetura nga Sektori i Kulturës
- Projekti "Trashëgimia dhe Inovacioni" Ojq Bonevet
- Projekti "Jehona e Traditës" Ojq Eduaktiv

- Projekti "Unë dhe Karriera ime" Ojq-APRFK
  - Ekspozitë "Ngjyrat e Trashëgimisë Sonë" Ojq-APRFK
  - Projekti "Promovimi i gjithëpërfshirjes në Mjedisin Kulturor" Doën Syndrome Kosova-Mitrovicë
  - Projekti "Global Music Fest 2024" Shoqata e Muzicienteve te Mitrovicës
  - Projekti "Promovimi i Artit dhe Kultures përmes fëmijëve" Ojq "Shqipet e Vogla"
  - Festivali "Mitrovica Guitar Days 2024" Ojq Kosova Ars
  - Festivali i Komedisë "Mitrix Culture"
  - Festivali "Green Fest" ojq 7 Arte
  - Festivali "Boletini n'Plis të bardhë"
  - Festivali "Promovimi i traditave dhe kulturës Mitrovicase" OJQ CECD
  - Festivali "Cicërrimat Buzë Ibrit"
  - Projekti "Panair" Promovimi i ushqimit dhe veshjeve tradicinale" Busines ëoman Mitrovica
  - Projekti -Panair "Veshjet Tradicionale" Gratë e Minatorëve
  - Projekti "Koncert Tradocional" HDSAI
  - Projekti "Sheshi Festiv" Ad Libitum
  - Panair "Kristalet e Trepçës" Ojq Minatori 88-89
  - Panair "Promovimi i vlerava tradicionale" Ojq Rinas
  - Dramë për Fëmijë" Ojq Aleksandër Moisiu"
- Sektori i Kulturë mbas mbështetjes së akvativiteteve kulutore ka arritë të ketë mbi 350 akvativitete kulturore.

**Ekspositat 2.** Puna muzeale dhe ekspositat Në vitin 2024, Muzeu i Mitrovicës ka realizuar një sërë iniciativash të suksesshme për të bërë muzeun një "Muze Gjithëpërfshirës". Përmes një bashkëpunimi të ngushtë me Drejtoren e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (DKRS), OJQ-të, dhe partnerët e tjerë, muzeu ka avancuar përfshirjen dhe aksesin për vizitorët e të gjitha grupeve shoqërore. Ky proces ka përfshirë risitimin e narrativave shpjeguese muzeale, përmirësimin e kushteve të ekspositave, si dhe përkthimin e materialeve në gjuhë të ndryshme dhe në alfabetin Braille, duke garantuar akses të barabartë për ata me aftësi të kufizuara. Po ashtu, janë realizuar përmirësime të infrastrukturës muzeale, përfshirë rregullimin e ndriçimit dhe vitrinave për një prezantim më dinjitoz të koleksioneve. Këto përpjekje kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit të muzeut dhe në rritjen e numrit të vizitorëve, duke pozicionuar Muzeun e Mitrovicës si një nga më të qasshmit për promovimin e trashëgimisë kulturore materiale në Kosovë, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët dhe përmirësuar përvojën kulturore të vizitorëve

- Risitimin e narrativave shpjeguese muzeale, ku janë pasuruar shpjegimet muzeale të objektit të ish-Armatës që muzeu e shfrytëzon, hartat dhe guidat udhëzuese në hyrje të muzeut, si dhe printimi i guidës për t'u dhruar vizitorëve.
- Përkthimin dhe printimin e guidave shpjeguese muzeale nga gjuha shqipe në atë serbe dhe angleze.
- Përkthimin dhe botimin e guidave shpjeguese muzeale në alfabetin Braille në gjuhën shqipe dhe serbe.
- Përkthimin e guidave shpjeguese në gjuhën e shenjave, të cilat u lanë të disponueshme në hyrje të muzeut.

- Rregullimin e ndriçimit të sallave ekspozuese dhe rregullimin e vitrinave arkeologjikeJanë ekspozuar fotografi dhe të dhëna arkivore të pa ekspozuara më parë;

- Janë trajtuar materiale arkivore për dy ekspozitat tematike si përvavarsitë si dhe tekstile të materialevë etnologjike;

Si dhe sistemimi i bibliotekës është punë në proces të vazhdueshëm, me inventarizim dhe risistemim librash nga koleksioni i bibliotekës muzeale

Numri i vizitorve në Muze u rritë gjithashtu nga vizitat e ekspozitave si dhe nga ngjarjet kulturore të shumta që u organizuan gjatë kësaj periudhe arriti në **5000**.

### **Biblioteka e qytetit “Latif Berisha”**

Sektori profesionalë gjatë muajve Janar-Qershori janë antarësuar 27 antarë me pagesë dhe 8 antarë janë liruar nga pagesa dhe ka pasur 1135 shërbime të kryera në sallë të leximit.

Sektori për të rritur 25 antarë dhe 16 pa pagesë me gjithësejt 733 shërbime

Sektori përfshin 81 antarë dhe 22 të liruar nga pagesa me 2360 shërbime të ofruara.

Gjatë kësaj periudhe ka pas 5 vizita nga shkollat fillore .

Në sektorin e përpunuimit janë përpunuuar 733 ekzemplarë librash për të gjithë sektorët.

### **Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica**

Me 2 dhjetor të vitit 2024 është bërë hapja solemne e Qendrës së Kulturës dhe në hapje janë organizuar disa aktivitete në të cilat aktivitetetë së bashku me stafin jemi angazhuar përmbarvajtjen e këtyre si dhe në punë të ndryshme që kanë dalë gjatë këtyre organizimeve. Gjatë rihapjës së Qendrës së Kulturës janë hapur edhe tri eksposita tematike, dy eksposita me piktura nga piktori Skender Indizi dhe skulptori Sabri Behramaj. Si dhe eksposita tematike “Mundem” me piktura të realizuara nga fëmijët më aftësi të ndryshme. Po ashtu nga data 2 deri me datën 7 dhjetor gjatë Festivalit të Komedisë Mitrix, stafi i Qendrës së Kulturës është angazhuar në punë të ndryshme si dhe në mbarvajtjen e këtij aktiviteti kulturor. Këto ditë është hartuar Agjenda e Aktiviteteve të cilat do të organizohen në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica”

**Objktivi 1:** Hartimi dhe realizimi i planit përmes mbështetjen kulturore.

Janë realizuar dy Thirrje Publike përmes mbështetje financiare të projekteve kulturore të OJQ-ve, me ç'rast janë mbështetur 27 projekte kulturore të OJQ-ve në shumë të përgjithshme prej 99,700 eurosh. Janë shqyrtuar gjithsej 78 lëndë e kërkesa të OJQ-ve dhe individëve.

**Objktivi 2:** Udhëheqje me Teatrin, Bibliotekën e Qytetit, Muzeun e Qytetit, Qendrën e Kulturës. Mbikëqyrja e vazhdueshme e mbarëvejtjes së punëve në këto institucione vartëse.

## **Teatri i Qytetit “Muharrem Qena”**

Edhe pse teatri ka qene ne renovim te salles dhe objektit te Q.K. deri n<sup>e</sup> mujain nentor ne teater jane zhvilluar aktivitetet e rregullta ditore te punes duke gjetur objekte alternativë per realizimin e programit vjetor te punes, si teatrin e Vushtrris dhe Muzeun e Qytetit. Teatri “Muharrem Qena” ka realizuar dy premiera të shfaqjeve teatrore dhe kemi filluar me shfaqjen e tretë pwr vitin 2024. Shfaqja per te rritur „Një vrasje e vogdl aksidentale” regjisore Marigona Bekteshi Ferati dhe Shfaqja per femije „Revolta e Presjes” regjisori Fatmir Hyseni

Në muajin shtator kemi marrur pjesë në festivalin e komedis në Suharekë me shfaqjen “Një vrasje e voël aksidentale” regjisore Marigona Bekteshi Ferati. Gjatë muajit tetor kemi filluar me shfaqjen „Provinca” regjisori Ard Islami.

Teatri „Muharrem Qena” gjatë muajit nëntorka qëndruar në Egjipt në qytetit Sharm El Sheikh Egjipt nd festivalin e teatrove Sharm El Sheikh International Theater Festival for Youth.

Po ashtu gjatë muajit nëntor teatri „Muharrem eena” ka qenë i angazhura ne festivalin e komedis Mitrixfest ku ka ndihmuar me të gjitha kapacitetet e teatrit.

## **Sektori i Rinisë**

Sektori i Rinisë, i cili vepron në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka si mision: fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje te të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale tek të rinjtë. Sektori i Rinisë ka për objektivë që të avansojë proceset të cilat ndërlidhen me rolin e të rinjve në komunë.

Politikat e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, konkretisht të Sektorit të Rinisë së Komunës së Mitrovicës së Jugut, janë:

- Avancimi i infrastrukturës rimore
- Pjesëmarrja aktive e rinisë në proceset shoqërore
- Krijimi i mundësive dhe përkrahja e punësimit të të rinjve
- Edukimi dhe parandalimi i dukurive të dëmshme për rininë

- Fuqizimi dhe qëndrueshmëria e Qendrave Rinore dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)
- Promovimi i Vullnetarizmit
- Integrimi i grupeve të marginalizuara
- Infrastruktura Rinore.

Ne kuadër të Sektori të Rinisë të Komunës së Mitrovicës së Jugut vepron KVRL (Këshilli i Veprimit Rinor Lokal) i cili ka mision përforcimin e organizatave rimore brenda komunave përkatëse, si dhe ndërtimin e një vizioni të përbashkët për rininë, po ashtu ne kuadër te sektorit te rinisë ekziston edhe Qendra Rinore e Mitrovicës, Qendra Rinore në Bare dhe Diakonia Youth Center që janë hapësira të funksionalizuara për zhvillimin e aktiviteteve të rinteve.

Sektori i rinisë bashkëpunon me Departamentin e Rinisë pranë MKRS-së, organizata vendore dhe ndërkombëtare. Sektori i rinisë në bashkëpunim me KVRL-në, Qendrën Rinore Mitrovica, Qendrën Rinore në Bare dhe Diakonia Youth Center si dhe Organizata të të ndryshme realizojnë projekte/aktivitete të ndryshme varësisht nga kërkesat/nevojat e të rinteve.

#### **Aktivitetet tradicionale të Sektorit të Rinisë organizon janë:**

- Aktivitete të ndryshme rimore për Ditën e Pranverës, 21 mars
- Aktivitete të ndryshme rimore për 31 Majin Ditën Ndërkombëtare kundër Duhanit
- Aktivitete të ndryshme rimore për Ditën ndërkombëtare të Librit, 23 prill
- Aktivitetet të ndryshme rimore për 26 Qershorin Ditën ndërkombëtare kundër narkotikëve
- Aktivitete të ndryshme rimore për Ditën ndërkombëtare të rinisë 12 gusht
- Aktivitete të ndryshme rimore për shënimin e Javës së Rinisë shtator
- Aktivitete të ndryshme rimore për shënimin e 1 dhejtorit ditës ndërkombëtare kundër HIV/AIDS
- Aktivitete të ndryshme rimore për shënimin e 5 dhjetorit ditës ndërkombëtare të vullnetarizmit

#### **Dokumente të rëndësishme të Sektorit të Rinisë janë:**

- Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë
- Strategja dhe Plani i Veprimit Rinor lokal 2014-2017, paraqet dokumentin zhvillimor për të rintjtë e Komunës së Mitrovicës, pa dallim gjinnie, besimi fetar apo komunitetit.

- Rregullorja Nr.04/2015 për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunë
- Bazuar në Ligjin për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë, në proces të hartimit janë nxjerre edhe draft Udhëzimet Administrative, siç janë:
  1. Udhëzimi Administrativ për pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje
  2. Udhëzimi Administrativ për Licencimin e Qendrave Rinore.
  3. Udhëzimi administrativ për punën vullnetare dhe
  4. Udhëzimi administrativ për Edukimin Jo-formal të të rinjve

Nga këto Udhëzime është hartuar dhe aprovuar Rregullorja Nr.04/2015 për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunë

Gjithashtu me vendim është bërë njohja e Këshillit të Veprimit Rinorë Lokal (KVRL) në Komunën e Mitrovicës së Jugut, këshill ky i cili funksionon si organ i përfaqësimit rinorë, i përbërë nga përfaqësuesit e organizatave rinore jofitimprurëse të nivelit lokal.

Në vitin 2014 është bërë miratimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal – Mitrovicë për vitet 2014 – 2017.

### **Objektiva 1: Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Organizatave Rinore**

Në kuadër të këtij objektivi është bërë ngritura e kapaciteteve për Organizatat Rinore lidhur me zhvillimin organizativ, ky objektivë është arritur përmes përkrahjës së projekteve rinore dhe mbështetja e nismave për aktivizmin rinor në komunitet mobilitetin rinor, si dhe përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë, ndërgjegjësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve.

### **Objektiva 2: Përkrahja dhe fuqizimi i Qendres Rinore dhe KVRL-se**

Gjatë vitit 2022 është pëkrahur financiarisht Qendra Rinore Publike dhe Qendrë Rinore në Bare si dhe KVRL-ja

### **Objektiva 3: Përkrahja për mobilitetin rinor**

Në kuadër të kësaj objektive zyratet nga Sektori i Rinisë kanë qenë pjesë e aktiviteteve të organizuara nga organizata vendore dhe ndërkombetare, aktivitete që kanë të bëjne me ndërgjegjësimin e komunitetit rinor për pjesëmarrje dhe qytetari aktive

### **Objektiva 4: Zhvillimi i vullnetarizmit**

Në kuadër të kësaj objective DKRS-Sektori i Rinisë ka promovuar punën vullnetare në Komunën e Mitrovicës, Kjo objektivë është arritu përmes mbëshjetjës finanziare të OJQ-ve rinore si dhe

organizimin e fushatave vetëdijësuese tek të rinjët për punën vullnetare dhe qytetarinë active.Promovimi i vullnetarizmit dhe i punës vullnetare

Shenimi i dites nderkombetare te vullnetarizmit

Organizimi ngjarjeve për promovimin e edukimit jo formal

#### **Objektiva 5: Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçje në tregun e punës**

Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe treg adekuat të punës

Për krahja e Organizatave Rinore që merren me këshillim dhe orientim në karrierë, shkathtësim dhe ndërmjetësim të rinisë me tregun e punës

Për krahja e nismave kreative për themelimin e bizneseve / ndërmarrësive të reja të të rinjve

#### **Objektiva 6: Mbështetja financiare e OJQ-ve**

Në vitin 2022 Drejtopria për Kulturë, Rini dhe Sport ka bërë një thirrje publike për mbështetje financiare të OJQ-ve duke u bazuar në Rregullorën 2017, Në këtë thirrje kanë përfituar 19 OJQ. Të bashkangjitur e gjenu tabelën e OJQ-ve përfituese:

### **Sektori i Sportit**

Sektori i Sportit, njëri nga tre sektorët e DKRS-së është përgjegjës për kordinimin e aktiviteteve sportive dhe mbarëvajtjen e punës në sektor.

Sektori i Sportit , njëri nga tre sektorët e DKRS-së është përgjegjës për kordinimin e aktiviteteve sportive dhe mbarëvajtjen e punës në sektor.

Ky Sektor vëmendje dhe përkushtim të veçantë i ka kushtuar klubeve sportive te qytetit tone , përmes formave të ndryshme të organizimit institucional duke shënuar aktivitete të ndryshme gjithëpërfshirëse.

#### **Objektiva1: Organizimi i turnirëve tradicionale ne Komunën e Mitrovicës**

Me datën 13.01.2024 është mbajtur turniri ne grupmosha U-11 dhe U-13 ne fushën sintetike , ku te pranishëm kane qene 48 ekipe ku ne mesin e këtyre ekipeve kanë marr pjesë edhe nga Shqipëria ,Maqedonia dhe Mali i Zi.

Me gjeneratën U-11 ishin pjesëmarrës 24 ekipe , kampion u shpall shkolla e futbollit ;forca nga Vushtrria.

Me gjeneratën U-13 ishin pjesëmarrës 24 ekipe , kampion u shpall shkolla e futbollit, Kurda nga Prishtina.

Realizimi i Turnirit tradicionale 17 shkurt dita e pavarësisë ne futboll te vogël.

Me datën 14.04.2024 është mbajtur turniri për Heroin e Kosovës Harun Beka , financimin e turnirit e ka bërë Drejtoria për Kulturë ,Rini dhe Sport .

Ne kete turnir vendin e parë e zyri Klubi futbollistik “Mitrovica “

Me datën 31.03.2024, është mbajt sportisti i vitit 2023 ne Vllla Lluks “ ku u be perzgjedhja e me te mirive .

Sportisti i vitit u zgjedh Basketbollisti Mitrovicas Drilon Hajrizi , ndërsa fitues i Çmimit “Lah Nimani” ish futbollisti dhe kontribuesi për sport Ferki Hajra

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ne bashkupunim me Shoqatën e Pedagogëve të Edukatës Sportive janë u zhvilluar garat Shkollore ne Baketboll, Hendboll, Volejboll dhe ne Futboll

Ne Basketboll kanë marr pjesë 18ekipe.

Ne ping pong kanë marr pjesë 16 ekipe .

Ne Futboll kanë marr pjesë 21 ekipe.

Ne Volejboll kanë marr pjesë 12 ekipe

Për nder të përvjetorit të rënies së heroit të kombit “Shemsi Ahmeti”, me dt.26.04.2024 duke filluar nga ora 11:00- 13:30 ne Palestrën Sportive “Minatori “ është mbajtur turnir në futboll të vogël, “Heronjtë e Shalës – “Komandant Shemi”.

Turnir është organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,- Sektori I Sportit në të cilën kanë marrë pjesë 6 ekipe.

Pas ndeshjeve të ndërsjella Veteranet e UCK- së e zuri vendin e parë

Me datën 10.Maj nga ora 11:00- 14:00 ne Palestrën sportive “Minatori” është zhvilluar finalja e Globalit të Shoqatës së Verbërve të Kosovës, aktiviteti sportiv i garave është zhvilluar sipas garave, mirëpo Federata e Shoq. Se verbërve ka bërë kërkesë në DKRS – sektorit te sportit në Mitrovicë finalja të zhvillohet në Palestrën Sportive “Minatori” sipas mundësisë të ju lirohet Termini për mbajtjen e finales së Globalit duke ditë se në Palestër mbahen shumica e aktiviteteve .DKRS – sektori i Sportit jua ka mundësua që finalja të mbahet sipas kërkesë së datës , orës se kërkuar, ndërsa federata i ka kryer obligimet për shpërblime me medalje dhe kupa. Pjesëmarrës ne finale ishin : Shoqata e Mitrovicës, Shoqata e Gjilanit , Shoqata e Pejës dhe shkolla speciale e Verbërve Peja, sipas rezultateve

Vendi I-re -Shoqata- Mitrovica

Vendi i II-të -Shoqata -Peja

Vendi i iii-të -Shoqata- Gjilani

Gjatë periudhës njëvjeçarë kemi vizituar klubet sportive, shoqatat sportive , objektet përcjellëse të DKRS-së , si Palestrën Sportive , Terrenet sportive.

KF “Mitrovica” shpallet kampion ne ligen e dyte te Kosovës dhe inkuadrohen ne ligen e pare KB ‘Trepça’ fitues i kupës se Kosovës dhe kampion i Kosovës,  
KH Trepça sigurimin e pjesëmarrjes ne Evropa ligë.

Gjate muajve maj dhe qershor DKRS ka punuar me komisionet për ndarjen e subvencioneve ne tre sektorët, rezultatet e OJQ-ve, Shoqatave kulturore dhe Klubeve Sportive janë shpallur ne ëebfaqen e Komunës.

Nga data 17 deri ne datën 20.09. /2024, në zyrën e sektorit te sportit janë nënshkruar kontratat me përfaqësuesit e klubeve , shoqatave sportive të përkrahura nga Kuvendi Komunal ne shpalljen e parë publike për subvencionime klubeve dhe monitorimin e përfitueseve e kanë sektori i sportit

#### **Subvencionimi i OJQ-ve Klubeve Sportive për vitin 2024**

<b>Nr.</b>	<b>Emri i Organizates/klubit</b>	<b>Emri i Projektit</b>	<b>Shuma</b>
1.	Kl.Basketbollit ”Trepça” (M)	Zh.i aktiviteteve sportive	50,000.00 €
2.	Kl.Futbollit . ”Trepça”89	Zhv.i aktiviteteve sportive	20,000.00 €
3.	Kl.Futbollit ”Mitrovica” (femrat)	Zhv.e aktiviteteve sportive	22,000.00 €
4.	Kl.Futbollit . ”Trepça”	Zhv.i aktiviteteve sportive	18,000.00 €
5.	Kl. Hendbollit”Trepça”(M)	Zhv.i aktiviteteve sportive	20,000.00 €
6.	Kl. Xhudos ”Trepça”	Xhudo dhe sporti	10,000.00 €
7.	Kl.Basketbollit ”Trepça” (F)	Zhv.i aktiviteteve sportive	15,000.00 €
8.	Kl. Futbollit ”Mitrovica ”	Zhv.i aktiviteteve sportive	20,000.00 €
9.	Kl. Fusall “ Trepça”	Garat ne fusall ne nivel vendi	6,500.00 €
10.	Kl. Hendbollit”Trepça”(F)	Subvecionimit i klubit ne gara	3,000.00 €
11.	Ojq Nic	Me kajak ne Liqe	3,000.00 €
12.	Ojq Qendra Nacio,e Vezhguseve	Lojrat sportive	1,000.00 €
13.	KI. Boksit “ diakonia ”	Aktivit. ne nivel vendi	1,000.00 €
14.	Kl. Karates ”Mitrovica ”	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	3,000.00 €

15.	OJQ Katuni i Moqum	Lojrat tradicionale fshatare	1,000.00 €
16.	KI. Zhytjes “Trepça”	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	6,000.00 €
17.	Kl. Notit “Mitrovica”	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	1,200.00 €
18.	Kl. Volejbollit “Trepça” (F)	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	3,500.00 €
19.	Kl. Çiklizmit	Çiklizmi për vitin 2024	1,000.00 €
20.	Kl. Atletikes ”Trepça”	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	2,000.00 €
21.	Kl. Atletikes ”Trepça”89	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	1,000.00 €
22.	Kl. Atletikes ”Mitrovica ”	Zhv.i garave për vitin 2024	2,000.00 €
23.	Ojq Opfakos	Garat ne nivel vendi	1,200.00 €
24.	Kl. Bilardos “Trepça”	Zhv. I garave ne bilardo	2,000.00 €
25.	Shoqata bjeshkatare “Trepça”	Subpcionimit i klubit ne gara	1,200.00 €
26.	KI. Boksit “Trepça”	Zhv.i garave për vitin 2024	1,000.00 €
27.	Kl. Veteraneve “Mitrovica”	Subpcionimit i klubit ne gara	5,000.00 €
28.	KI. Futbollit ‘ Shpresa’	Zhv.i garave për vitin 2024	1,200.00 €
29.	Kl. Armcrushers “Trepça”	Garat ne nivel vendi	2,000.00 €
30.	Kl. Top Team ”Mitrovica ”	Subpcionimit i klubit ne gara	1,000.00 €
31.	Shoqata kosovare mini futboll	Aktivit. ne nivel vendi	1,000.00 €
32.	Kl.i Basketbollit ”Veteranet”	Aktivit. ne nivel vendi	1,000.00 €
33.	Ojq Masterboll	Zhv.i garave ne për vitin 2024	1,200.00 €
34.	KI. Tenisit ”Trepça”	Aktivit. ne nivel vendi dhe lokal	1,000.00 €
35.	Kl. Fusall “Minatori”	Zhv.i garave për vitin 2024	4,000.00 €
36.	Asociacioni i parasht. Kosovës	Gare një shenjtëri	1,000.00 €
37.	KI. Mundje krahу ”Trepça”	Zhv.i garave për vitin 2024	1,500.00 €
38.	Travil Explorers Kosova	Pjesmarrja ne gara	1,000.00 €
39.	Kl. Pers, me aft, kuf ”Minatori “	Sporti dhe natyra	1,200.00 €
40.			

### **Objetiva3: Panairi i sportit ne Komunën e Mitrovicës**

Ne kuadër te ditëve te diasporës Drejtoria për kulturë Rini dhe Sport ka organizuar panairin e sportit ne sheshin “ Mehë Uka” nga data *18.07.2024 deri 30.08.2024* ku pjesëmarrës kanë qene te gjitha klubet sportive Me datën 28.11.2024 është mbajte turniri ne futboll te vogël për ditën e pavarësisë ke kanë marr pjesë klubet e qytetit tone dhe ne finale shkuan KF” Trepça” dhe KF” Mitrovica ” , dhe Klubi Trepça e zuri vendin e parë

Me respekt,

Fahri JASHARI

Drejtor i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport

